



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*  
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*  
*Ministry of Local Government Administration*

Datë, 05.06.2013  
Nr. 0204-627

**PËR:** Samjl Latifi, Kryetar i Komunës së Rahovecit  
Xhemali Haxhimustafa, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Rahovecit

**LËNDA: KONFIRMIM I LIGJSHMËRISË SË VENDIMIT TË KOMUNËS SË RAHOVECIT,**  
01 NR.27/2013 të pranuar me datë, 13.05.2013

Të nderuar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me nenin 82 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, shtojcën XII të Rregullores Qeveritare Nr.02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, pas shqyrtimit të Vendimit 01 nr. 27/2013 të miratuar me datën 30.04.2013 nga Kuvendi i Komunës së Rahovecit, **KONFIRMON** ligjshmërinë e këtij akti dhe vlerëson se i njëjti është në harmoni me Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale dhe Ligjin Nr. 04/L-144 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.

Akti juridik i listuar si vijon, ka efekt të plotë juridik.

- Vendim 01nr.27/2013 për shpalljen e zonës së veçantë të interesit publik të ngastrës kadastrale nr.1753/1 në vendin e quajtur Ratkoc.

Me respekt,

**Slobodan Petrović,**  
**Zëvendëskryeministër & Ministër i MAPL-së**

**Kopje:** Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm i MAPL-së  
Udhëheqësve të Departamenteve të MAPL-së  
Arkivit të MAPL-së



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*  
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*  
*Ministry of Local Government Administration*

Dana: 05.06.2013  
br. 0204-627

**Za:** Smailj Ljatifi, Gradonačelnik Opštine Orahovac  
Xhemali Haxhimustafa, Predsedavajući Skupštine Opštine Orahovac

**PREDMET: POTVRDA ZAKONITOSTI ODLUKE OPŠTINE ORAHOVAC,**  
**01 Br. 27-2013, Priljeno dana, 13.05.2013**

Poštovani-e

Ministarstvo administracije Lokalne samouprave, u skladu sa svojim mandatom odredjenim po članu 82 Zakonu za lokalnu samoupravu Br. 03/L-040, dodatak XII Uredbe Vlade 02/2011 o poljima administrativne odgovornosti kabineta Premijera i Ministarstva, posle razmatranja Odluke 01Br.27-2013 usvojene dana 30.04.2013, od Skupštine Opštine Orahovac, **POTVRDJUJE** zakonitost ovog akta i ceni da je isti u skladu sa Zakonom Br.03-L-040 za lokalnu samoupravu i Zakon Br.04-L-144 za davanje na korišćenje i razmenu nepokretne opštinske imovine.

Pravni Akt navaden u nastavku, ima puni pravni efekat .

- Odluka 01Br. 27-20123 , za objavljivanje zone od posebnog interesa katastarske parcele br.1753-1 u mestu zvanom Ratkoc

S poštovanjem,

**Slobodan Petrović,**  
**Zamanikpremijera i Ministar MALS-a**

**Kopija:** Besnik Osmani, Generalni Sekretar MALS-a  
Rukovodiocima uprava MALS-a  
Arhivi MALS-a.



*deyshin*



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Kuvendi i komunës së Rahovecit – Skupština opštine Orahovac

Në bazë të nenit 10 dhe 11 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr. 03/L040, nenit 7 të Ligjit për dhënjën në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës nr. 04/L-144, nenit 13 dhe 84 të Ligjit për procedurën administrative nr. 02/L-28 dhe nenit 5 të Statutit të komunës së Rahovecit, Kuvendi i komunës së Rahovecit, në mbledhjen e vet të mbajtur më 30.04.2013, merr

**V E N D I M**

**Mbi shpalljen e Zonës së veçantë të interesit publik**

**Neni 1**

Shpallet zona e veçantë e sigurimit të interesit publik komunal dhe caktohet lokacioni për ngritjen e objekteve afariste të biznesit në ngastrën kadastrale nr. 1753/1, sipas kulturës kullosë (djerrinë) në sipërfaqe prej 0.90,99 ha, nga çertifikata mbi të drejtat e pronës së paluajtshme nr. 260 z.k. Ratkoc, PSH e Kosovës, KK Rahovec.

**Neni 2**

Caktimi i lokacionit në ngastrën komunale nr. 1753/1 për ndërtimin e objekteve afariste të biznesit i plotëson të gjitha kushtet urbanistike e cila gjendet në rajonin e ngusht ndërtimor, është në përputhshmëri me Planin zhvillimor të komunës dhe mund t,iu jipet personave fizik dhe juridik në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë, sipas kriterëve të përcaktuara në Ligjin për dhënjën në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme nr. 04/L-144 dhe Udhëzimit administrativ nr. 2012 për zbatimin e këtij ligji dhe Ligjit për prokurim publik nr. 04/L-042.

**Neni 3**

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për urbanizëm, planifikim dhe dhe mbrojtjen e mjedisit të KK Rahovecit.

**Neni 4**

Ky Vendim hynë në fuqi me ditën e aprovimit nga Kuvendi i komunës së Rahovecit.

**KUVENDI KOMUNAL RAHOVEC**

01 nr. 27/2013

Rahovec, më 30.04.2013



Kyesuesi i Kuvendit  
**Xhemali Haxhimustafa**

22 7.05.13